



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 19, datë 27. 04. 2023

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË BONUSIT TË QERASË SË BANESËS
FAMILJES SË Z.SYRJA SHKËMBI, NJËSIA ADMINISTRATIVE QËNDËR,
BASHKIA SKRAPAR”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 27.04.2023, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 29, “Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike”, pika 1, Ligjit Nr. 22/2018, “Për Strehimin Social”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Skrapar Nr.86, datë 21.12.2022 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit të vitit 2023 për Bashkinë Skrapar dhe institucionet ne varësi të saj”, si dhe kërkesës së paraqitur nga shtetasi Syrja Shkëmbi,

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit të qirasë së banesës 1+1, ndodhur në Lagjen “2 Dhjetori”, në Çorovodë, për strehimin e familjes së Z.Syrja Shkëmbi, për periudhën Maj 2023 - Maj 2024, në vlerën 5000 (pesë mijë) lek në muaj.
2. Vlera totale 60.000 lekë, për periudhën Maj 2023 - Maj 2024, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602, zëri “Shpenzime Operative Administrata”, në Programin Buxhetor Administrim, Planifikim, Menaxhim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vendimi u miratua me 10 vota pro , votë kundër – s’ka, vota abstenim - s’ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

